

SHTATËMBËDHJETË  
ARËSYE  
PËR LIBRIN  
PËR FËMIJË



HELSINGBORG  
BIBLIOTEK

*Akademia Suedeze e librit për fëmijë*

Libri na jep argëtim dhe  
zgjon interes.

Libri na bën të qeshim dhe  
të qajmë.

Librin na ngushëllon dhe na  
rrëfen për  
mundësi të reja.



Libri na ndihmon në zhvillimin e gjuhës tonë dhe pasurimin e saj me fjalë të reja.

*shtatëmbëdhjetë arsye...  
shtatëmbëdhjetë shpirtëra  
- të njëjta mendime  
17 vjedhin, 2 i zanë, -  
në dreq të mallkuar sa të  
pashpirtë!*



Libri stimulon fantazinë dhe na ushtron në krijimin e fotografive të mbrendshme.

4

Libri mund të zgjojë pyetje të reja  
të cilat na  
angazhojnë dhe na japin diçka të  
mendojmë  
më tutje.

5

Libri zhvillon mendimet tona.  
Ai na jep kuptim që të mendojmë  
në forma  
të reja, ai zgjeron vetëdijësimin  
tonë dhe botën tonë.

*Ky derri është  
zëri i ndërgjegjës!*



Libri na jep njohuri për shtetet  
tjera dhe forma të ndryshme  
të jetesës, për natyrën, teknikën,  
historinë dhe gjithçka mes qiellit  
dhe tokës për të cilat ne  
dëshirojmë të  
dimë më shumë.



Libri ushtron aftësinë tonë të mirëkuptimit. Ai na jep neve mundësi që ne të ndiejmë situatat dhe ndienjat e të tjerëve.



Libri na bën të kuptojmë për atë se çka është e drejtë dhe e gabuar mirë apo keq.

9

Libri mund të spjegojë realitetin dhe na ndihmon ti kuptojmë rrethanat e ndryshme.

10

Libri mund të na rrëfen që jo gjithmonë ekziston vetëm një përgjigje rreth një pyetje, libri na rrëfen se çdo gjë mund të vërehet/ shifet nga shumë kënde/ anë.



*Unë jam i vogël.  
Unë jam i madh.*




Libri na ndihmon ta kuptojmë  
vetëvehten.

Ai forcon vetëbesimin tonë në  
kuptimin se  
edhe tjerët mendojnë dhe ndiejnë  
si ne.

*Ajo është pikërisht  
si unë*



Libri na ndihmon të kuptojmë që  
ne jemi  
të ndryshëm. Të lexosh libra të  
shkrimtarëve  
të ndryshëm të kohërave të  
ndryshme dhe  
të kulturave të ndryshme, ngrit  
nivelin e  
tolerancës dhe ndihmon në  
luftimin  
e paragjykitimeve.



Libri na shoqëron kur ndihemi të  
vetmuar. Është lehtë të merret me  
vehte  
dhe mund të lexohet në çdo vend.  
Libri  
mund të huazohet falas në  
bibliotekë.



Libri është pjesë e trashëgimisë  
kulturore.

Libri na lë mbresa të përbashkëta  
të cilave mund çdo herë tju  
kthehemi .



Një libër i mirë për fëmijë bën të  
lexohet me  
zë të lartë që njëkohësisht si fëmiu  
dhe i rrituri  
te ndjejë kënaqësi gjatë leximit.  
Kështu libri  
bëhet një urë mes gjeneratave.



Libri për fëmijë angazhon/  
punëson një  
mori njërëzish: shkrimtarë,  
piktorë,  
redaktorë, botues, formulues,  
korrektorë, fotografë, bibliotekistë  
shtypshkronjat, libraritë etj.  
Në këtë formë libri ndikon në  
pasurimin  
e jetës kulturore dhe është pjesë e  
rëndësishme  
e eksportit kulturor që e bën  
shtetin tonë  
të njohur në botë.

Libri për fëmijë është kontakti i  
parë me literaturën,  
Një botë e pafund që vlen gjithë  
jetën.



Nëpërmjet të librit bëhem njëmijë  
njerëz,

Megjithëatë mbetem unë:

C.S. Lewis

Libri më jep shembuj dhe përjetime  
që të mendoj.

Aidan Chambers

Një libër është një kopsht që mund ta  
mbajmë në xhep.

Fjalë e urtë Arabe

Unë shkruaj për fëmijë për arsye që  
ata të

mos presin që shkrimtari i tyre i  
dashur

duhet shpëtuar njerëzimin. Të rinjë  
ashtu si

janë, e dinë se këtë fuqi nuk e ka  
shkrimtari.

Vetëm të rriturit kanë iluzione  
fëmijësh.

I.B.Singer

Tri funksionet e rëndësishme të  
librave me  
Fotografi janë:  
Takimi i fëmijëve me vizatimin -  
artin  
Takimi i fëmijëve me literaturën  
Takimi i fëmijëve me prindërit.  
Funksioni i tretë që përmban libri  
me fotografi,  
sipas mendimit tim është më me  
rëndësi.

Max Lundgren

**Akademia suedeze për libra për fëmijë**  
**Biblioteka Skärholmen, Bredholmsgatan 4**  
**SE 127 48 Skärholmen**  
**[www.barnboksakademin.com](http://www.barnboksakademin.com)**